

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E HËNË 6 QERSHOR 2022

E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Nga takimet që zhvillova këtë javë me banorët e njësive administrative, që kam nderin dhe privilegjin t'i përfaqësoj, kam tri fjalë kyçe, të cilat po i sjell sot për diskutim për të reflektuar dhe për të dëgjuar. Së pari, ishte fjala "përgëzim". Shumë përgëzime për secilin nga ne, deputetët e këtij Kuvendi, për procesin e zgjedhjes së Presidentit të Republikës! Për pezakët, ndroqarët dhe vaqarrasit ky ishte një proces shumë i rëndësishëm; ishte një proces, për ata që dinë të bashkohen në momente të vështira në historinë e kombit tonë që i dha mundësinë kujt do të përfshihej; i dha mundësi opozitës, e cila, si ata dashnorët e turpëruar, donte të thoshte "po", donte të thoshte "dua", por nuk arriti dot ta thoshte. Ky proces na e dha mundësinë ne, çdo deputeti të maxhorancës, por edhe të gjithë qytetarëve që të përfshiheshin.

Në fund, përveçse ishte një proces gjithëpërfshirës dhe transparent, ishte një proces i suksesshëm, sepse në fund të ditës ktheu një njeri në zyrën më të lartë të këtij vendi, një qytetar dhe një profesionist. Të gjithë presin që politika boshe, politika bajate të dalë nga ajo zyrë dhe të kthehet shtetbërja, të kthehet formimi dhe forcimi i këtij shteti. Së dyti, ishte fjala "mirënjohje". Mirënjohje për të gjithë ju, që keni miratuar paketat e rimëkëmbjes infrastrukture! Investimet infrastrukture arsimore në zonën që unë përfaqësoj, janë investime që bëhen njëherë në një brez të tërë, kam parasysh 4 shkollat, të cilat janë të denja për t'i modernizuar më tej proceset arsimore. Jam i bindur që ministrja e Arsimit do të vijojë me plotësimin e kabineteve, me të gjithë bazën materiale, por edhe me programet arsimore, që të mund të vazhdojë modernizimi arsimor.

Së treti ishte fjala "Rimëkëmbja komunitare". Në secilën nga njësitë administrative që përfaqësoj kemi një lagje të re, që janë lagjet e shpresës, janë lagjet që shënojnë dhe festojnë. Momenti më i errët i asaj zone u kthye në një nga momentet më të gëzueshme; e kam fjalën

për lagjet që u ndërtuan pas tërmetit, ku sot banojnë familje, të cilat i janë kthyer jetës normale. Në fund kam edhe një kërkesë për ministren Balluku, të cilën jam i sigurt që e ka dëgjuar, por nuk mund të rrija pa e sjellë këtu; ajo është për rrugën Kombinat – Plepa, që për ata banorë është rruga e zhvillimit, është rruga me të cilën dalin në treg; është rruga me të cilën aksesojnë kryeqytetin, por edhe banorët e kryeqytetit aksesojnë trashëgiminë kulturore, historike, por edhe turizmin. Ajo rrugë ka pasur disa ndërhyrje.

Në vitin 2018 mbaj mend që ka pasur një ndërhyrje të qenësishme për ta riparuar, por me sa duket kësaj rruge i ka ardhur momenti për rikonstrukcion. Ndaj, sjell kërkesën e atij komuniteti që ndërhyrja që do të bëhet kësaj radhe duhet ta rregullojë njëherë e mirë aksesin e banorëve për shërbimet që ofrohen në kryeqytet, për jetën e kryeqytetit dhe anasjelltas. Ndaj, pa humbur kohë dhe pa ju marrë më shumë minuta, këto ishin tri fjalët kyçe që doja të sillja: përgëzim, mirënjohje, por edhe këtë kërkesë të qenësishme për qeverinë. Faleminderit!